



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të dispozitave të nenit **19.2** të Rregullores së UNMIK-ut nr. **2000/45**, dispozitave të nenit **1, 2, 4** dhe **5** të Udhëzimit administrativ për pagesën e stafit politik të komunave nr. **7/2004** për pjesëmarrje në mbledhje të Kuvendit apo të komiteteve, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 31.01.2005, mori

V E N D I M
MBI KOMPENSIMIN PËR ANËTARË TË KUVENDIT DHE ANËTARË
TË KOMITETEVE PËR VITIN FISKAL 2005

- I. ANËTARËVE TË KUVENDIT**, kompensimi mujor në shumë prej **70 (shtatëdhjetë) €** dhe shuma prej **30 (tridhjetë) €**, për çdo mbledhje të mbajtur.
- II. ANËTARËVE TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**, kompensimi mujor në shumë prej **100 (njëqind) €** dhe shuma prej **30 (tridhjetë) €**, për çdo mbledhje të mbajtur.
- III. KRYETARËVE TË KOMITETEVE**, kompensimi mujor në shumë prej **80 (tetëdhjetë) €** dhe shuma prej **20 (njëzet) €**, për çdo mbledhje të mbajtur.
- IV. ANËTARËVE TË KOMITETEVE**, kompensimi mujor në shumë prej **30 (tridhjetë) €** dhe shuma prej **20 (njëzet) €**, për çdo mbledhje të mbajtur.
- V.** Për zbatimin e këtij Vendim interesohet, **kryetari** i Kuvendit të Komunës dhe **Drejtorati për Financa dhe Pronësi**.
- VI.** Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. Nr. 031-1959 Dt 04.02.2005

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri